

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[26.11.2018]

Për: *ALAR FOOD & SERVICE shpk*

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat”.

Numri i referencës së procedurës: REF-83297-08-17-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Berat për periudhën nga nënshkrimi i kontratës deri më 31.12.2018 me fond limit 3.335.586 (*tre milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. SORI-AL K31510059D
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera 3.319.460,43 (tre milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dyzetë e tre)

2. ALAR FOOD & SERVICE L518080270
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera 2.738.290 (dy milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë e dyqind e nëntëdhjetë)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. SORI-AL K31510059D
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar si Kapacitet Teknik, në pikën 4 të seksionit 3.3 të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim të DT, sepse nuk arriti të paraqesë një certifikatë që vërteton menaxhimin për sigurinë ushqimore - analizën e rreziqeve dhe pikat kritike të kontrollit (HACCP) të shoqërisë SORI-AL shpk. Certifikata e paraqitur N.11928 nuk është lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga një organizëm kombëtar ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Subjekti Certiquality s.r.l (Istituto di Certificazione della Qualita, Italy) lëshues i certifikatës së paraqitur N:11928, nga verifikimet e kryera në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018, nuk rezulton i akredituar për certifikimin e menaxhimit të sigurisë ushqimore - analizës së rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP). Po ashtu në certifikatën e lëshuar nuk rezulton kush është organizmi akreditues kombëtar/ndërkombëtar për OVK Certiquality s.r.l Italy. Nga verifikimi i bërë në organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së, nuk rezulton që OVK Certiquality s.r.l të jetë i akredituar nga ndonjë prej tyre për HACCP.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *ALAR FOOD & SERVICE me adresë: Tirane, Kashar, Rruga Dytesore Tirane-Durres, brenda tregut Agro Ushqimore, KM -1, ZK.2679*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 2.738.290 (dy milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë e dyqind e nëntëdhjetë) lek pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Spitalit Rajonal Berat* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.11.2018.

Ankesa: nga "SORI AL" ka marrë përgjigje në datë 11.09.2018 me shkresën nr.866/1.